

KRIKIKA DHE RECENSIONE

Vladimir Bovan, SRPSKE NARODNE TVOREVINE SA KOSOVA I METOHIJE, „Jedinstvo”, Prishtinë 1978, f. 319.

Në librin *Govorne narodne tvorevine* (Krijime popullore gojore), Vladimir Bovan ka përmbledhur krijimet gojore, që do të përbënim llojin e veçantë — të tretë e që nuk i përket as lirikës, as epikës, as tregimit gojor, pasi nuk mbruan specificitete të tyre. *Krijimet gojore* për të cilat është fjala, nuk këndohen, s'kanë syzhe, janë të shkurtra. Krijimet popullore gojore (Krijimet e folura gojore, siç jepet në përkthim ndonjëherë), autori i ndan në: 1. yshtje 2. mallkime, betime, bekime 3. përshëndetje (doli) 4. gjëgjëza 5. pyetje-përgjigje 6. proverba 7. thënie 8. fjalë që shqiptohen shpejt dhe lojëra fjalësh. Për secilin krijim autori na jep nga një vështrim të shkurtër, e pas çdo analize i paraqet krijimet e mbledhura nga veprat, dorëshkrimet, „arkivat familjare”, të përkohshmet e ndryshme etj. Në vepër janë përfshirë 25 yshtje, 126 mallkime, 44 betime, 57 bekime, 18 përshëndetje, 410 gjëgjëza, të cilat i mbarështron në kashelashe që bëjnë fjalë për natyrën, për bimët, për kafshët, për njeriun, për nevojat njerëzore, për shtëpinë, për mjetet e punës dhe për jetën shoqërore. Në vepër gjejmë: 63 pyetje-përgjigje, 326 proverba, 430 thënie, 326 thënie — krahasime, një sërë fjalësh që shqiptohen shpejt dhe lojëra gojore.

Yshtjet, sipas autorit, u përkasin formave më të vjetra të krijimeve popullore gojore, ato janë formula magjike, farë lutjesh, apo „kërcënimesh” — drejtuar sëmundjes, që ka sulmuar fëmijën, kafshën ose bimën. Kjo masë konsiderohet si njëlloj bari për ta dëbuar të keqen. Njëpërmjet yshtjeve luftohen sëmundjet te fëmijët, por edhe te të moshuarit, sidomos pagjumësia, shpirtrat e ligj, shtrigat,

frika, verdha etj. Yshtjet u përngjajnë mallkimeve. Here-herë ato sikur e mbruan mallkimin e thjeshtë. Rëndom në to dominon një ton lutjeje, që i afrohet bekimit. Here-herë yshtjet i përngjajnë betimit. Yshtjet si *formula magjike* e kanë humbur funksionin e tyre të dikurshëm.

Mallkimet, betimet dhe bekimet, autori i ka renditur në një grup. Sipas Bovanit, mallkimet bazohen në besimin, në fuqinë magjike të fjalës. Si formë e krijimtarisë popullore gojore ato janë të ngjashme. Mallkimet, betimet dhe bekimet, u përngjajnë yshtjeve, kurse bekimet janë më afër dollive (f. 42). Bukuria e këtyre krijimeve qëndron në një specifikë që më së shumti i shquan — në dendurinë dhe në shprehjen ekspresive (f. 42).

Nëmët shfaqin dëshirën për t'ia lëshuar të ligat dikuj. Këto bazohen në besimin, në forcën magjike të fjalës. Ndonëse funksioni i nëmëve ka pushuar, ato edhe sot e kësaj dite përdoren me të madhe.

Betimet përdoren për të dëshmuar sinqeritetin, saktësinë, vërtetësinë e fjalës së dhënë, kurse përmes bekimeve shfaqen dëshira për të pasuar diç e mirë, gëzimi, fitimi etj.

Përmes *përshëndetjeve* shfaqen dëshira për përparimin e njeriut, konakut (familjes), në raste dasmash, lindjesh, shirjesh etj.

Gjëgjëzat si forma më të vjetra të krijimeve popullore gojore, autori i ka ndarë në kashelashe që flasin për natyrën (57), për bimët (48), për kafshët (56), për njeriun (36), për nevojat njerëzore (72), për shtëpinë (69), për mjetet e punës (48), për jetën shoqërore (24).

Pyetje-përgjigjet përkufizohen si krijime që shprehin diç thelbore, me

këtë veçori shquese këto u përngjajnë proverbave. „Vlera letrare e pyetje-përgjigjeve qëndron në shprehjen e dendur” (f. 157). Në të vërtetë është pikëpyetje nëse kjo veçori është apo s’është karakteristikë që i shquan pyetjetje — përgjigjet.

Fjalët e urta autori i definon si shprehje të dendura, mbi atë që e hetojmë te njeriu, në jetën e tij. Te të faqe të veprës ia kushton kësaj trajte të dendur të krijimtarisë gojore, duke na dhënë informacione e definicione të autorëve — paremiologë të vendit.

Libri i Bovanit mbruan një numër të konsiderueshëm proverbash, që realisht s’përkojnë me fjalën e urtë: Ako očeš mnogo, uzmi malo (nr. 13, f. 179). Volim prvo sebe pa tebe (nr. 39, f. 180). Živome se uvek nađe čare (nr. 86, f. 182). Od beter ima još po beter (nr. 243, f. 188). Svakome svoje a mene moje (nr. 289, f. 189). Tudiina, tuga golema (nr. 319, f. 190).

Përkundër këtyre shprehjeve të rëndomtë, autori ka herrur nga libra (vepra) të ndryshme fjalë të urta me vlera etike, filozofike, që bëjnë fjalë për marrëzinë, për vuajtjen, për forcën e fjalës, për drejtësinë, për nderin, për miqësinë, për armiqësinë, për egoizmin etj.

Budalu vrzano kuće ujeda (nr. 31, f. 180). Zid ruši vlaga, a čoveka der i tuga (nr. 98, f. 183). Iglom se bunar ne kopa (nr. 111, f. 183). Jezik nema koske ali krši koske (nr. 128, f. 184). Ko ne sluša mater slušaće maćiju (nr. 167, f. 185). Krivo da sedimo, pravo da zborimo (nr. 175, f. 185). Obraz nema više od dva prsta, ali više vredi od dva sveta (nr. 41, f. 188). Prijatelj te gleda u oči a dušmanin u noge (nr. 269, f. 189). Svoj svojega ne rani, samo teško onomu kuj ga nema (nr. 293, f. 190). Slamku vidi na drugoga a po sebe gredu ne vidi (nr. 299, f. 190). Trulovo drvo direk ne biva (nr. 316, f. 190). U čoravoj zemlji i slepi konji prolaze (nr. 344, f. 191).

Në libër autori thënie i përkufizon si shprehje të shkurtra, të dendura, por pa arsye pohon se për nga pëmbajtja janë më të pasura edhe prej proverbave, gjoja për shkak të „kërkesës normative në lëmin e sjelljes morale” (f. 194).

Në faqet (193—203), ku flitet për thënie, hasim në disa kundërthënie,

sidomos kur pohohet se ato nuk përmajnë fare mesazh. Në të vërtetë, edhe te proverbat, edhe te thënie, në shumë raste porosia jepet në mënyrë implicite. Bëhet pyetja: cilat janë ato thënie që nuk kanë farë mesazhi?

Në *Krijime* një numër i madh shprehjesh që autori i konsideron si thënie, ato në të vërtetë nuk janë të tilla: Bilo pa se izarčilo (nr. 18, f. 205), Bog pa ti! (nr. 20, f. 205), Bog s’ tobom (nr. 21, f. 205), Budi bog s’nama (nr. 22, f. 205), De si srečo! (nr. 50, f. 206), Za boži se vap (nr. 78, f. 207), I velika rabota (nr. 91, f. 207), Ide mu od ruke (nr. 94, f. 208), Izgubio put (nr. 104, f. 208), I on ima dušu (nr. 112, f. 208), Magareća rabota (nr. 145, f. 209), Ne dao bog (nr. 175, f. 210), Ne faća mesto (nr. 193, f. 211), Nikakav čovek (nr. 195, f. 211), Niko bez beane nije (nr. 197, f. 211), Njegova rabota (nr. 217, f. 212), Oči na oči (nr. 260, f. 213), Svaki gleda svoju rabotu (nr. 313, f. 215), Seljačka rabota (nr. 318, f. 215), Sprema čoveku (nr. 334, f. 215), Tako je: čovekovo ne se zna (nr. 347, f. 216), Čorava rabota (nr. 388, f. 217), U pijanstvo čovek oće da rekne svašta (nr. 403, f. 218), Čas pocrveni, čas pobeli (nr. 415, f. 218), Čovek ne zna kakav je bio u detinjstvo (nr. 418, f. 218).

Autori i librit duke e njëjtësuar thënien ose proverbin — krahasim me krahasimin si trop i konsideron si thënie: Bistra kaj suza (nr. 4, f. 219), Vedro kaj oko (nr. 14, f. 219), Žena kaj lađa (nr. 44, f. 220), Zdrav kaj dren (nr. 51, f. 221), Prav kaj strela (nr. 180, f. 225), Prav kaj bor (nr. 181, f. 225), Pun kaj oko (nr. 191, f. 225), Slatko kaj šerbet (nr. 223, f. 227), Spava kaj Zaklan (nr. 228, f. 227), Tvrd kaj kamen (nr. 246, f. 227), Teško kaj kuršum (nr. 253, f. 227), Crn kaj tiganj (nr. 289, f. 229), Crn ka čumur (nr. 290, f. 229).

Në mesin e shprehjeve të rëndomta që paraqesin vetëm figura stilistike, hasim edhe fjalë të urta që shquhen për nga kuptimi i tyre i thellë, pavarësisht a janë produkt i gjuhës në të cilën janë paraqitur.

Në jetë e mira dhe e keqja jo rralëherë i ndërrojnë vendet, ose e ndërrojnë „objektin” që e godasin. Mu aty qëndron ironia, se ato tro-

kasin në çdo shtëpi, vizitojnë çdo njeri: *Ide kolo na okolo* (Sillet vâlja rrotull-o, nr. 95, f. 208).

Njerëzit ndonjëherë rreken për oso punësh që s'janë të tyre, për punë që s'janë të zotët t'i qesin në krye, ndaj fundi i përpjekjes së tyre përfundon keq: *Isla krava na oranje pa usrala gredel* (nr. 117, f. 208).

Njerëzit e ndryshëm për punë të ndryshme kanë përvoja të shumëndurshme, ruajnë doke, zakone që përkojnë me kohën: *Koliko sela, toliko adeta* (Fshat e zanat, nr. 133, f. 209).

Puna që kryhet herët, gjëja që selitet me kohë, jep edhe fryte të hershme: *Rano pile rano poje* (nr. 299, f. 214).

Shquhen me vlerat e tyre, me mendimin filozofik proverbat: *Tija voda breg roni* (nr. 364, f. 216), *Udavljenik se za slamku faća* (nr. 391, f. 217).

Në 16 faqe, jepet një pasqërë historike për fjalët e urta, ndërsa në fund të librit jepet një pasthënie dhe bibliografia e përdorur si dhe fjalori i fjalëve të panjohura.

RAHMI TUDA

KËNGË DASHURIE I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Rrustem Berisha dhe Myzafere Mustafa, Prishtinë, 1979.

Bleni „*Këngë dashurie I*”, i përgatitur nga Rrustem Berisha dhe Myzafere Mustafa, është vëllimi i pestë i serisë së botimeve të letërsisë popullore që bën pjesë në makroprojektin e Institutit Albanologjik, i cili parashih botimin e 25 blenjve të lëndës folklorike të shqiptarëve të Jugosllavisë. Ky vëllim përfshin 353 këngë dashurie që janë mbledhur në treva të ndryshme nga bashkëpunëtorët e jashtëm dhe nga punonjësit shkencorë të Institutit.

Kënga e dashurisë është një nga llojet shumë të përhapura të lirikës popullore shqiptare. Ajo ka filluar të mblidhet e të botohet që nga mbledhësit e parë të folklorit shqiptar. Këtë lloj të këngëve e gjejmë në të gjitha vëllimet e lirikës popullore shqiptare që janë botuar deri me tash. Mirëpo, ky është libri i parë që në tërësi i kushtohet poezisë popullore të dashurisë dhe përmban vlera të konsiderueshme poetike të lirikës së mirëfilltë popullore. Kur themi lirikë e mirëfilltë kemi parasysh faktin se kënga e dashurisë, ndryshe nga llojet e tjera të lirikës popullore që lidhet me rite e zakone të ndryshme të traditës etnografike e folklorike të popullit, është krijim poetik që ka pikënisje të drejtpërdrejtë ndjenjat e fuqishme të dashurisë së të rinjve.

Dashuria si ndjenjë, që e ka zanafillën e vet që nga fazat më të hershme të zhvillimit të njeriut dhe të raporteve të tij në sferën e krijimit të familjes dhe të ruajtjes së gjinisë

njerëzore, i ka kushtëzuar marrëdhëniet më suptile të afrimit dhe bashkimit të të rinjve të të dyja gjinive. Kjo ndjenjë është manifestuar me tërë fuqinë e vet në një pjesë të madhe të krijimtarisë poetike të traditës popullore. Mirëpo, ajo del e plotë, e pasur me nuancat më të ndjeshme të botës intime të njeriut si dëshirë, ndjenjë, si burim frymëzimi, gëzimi, shqetësimi, malli e nostalgjie, si bukuria madhështore, por edhe tragjike, vetëm në këngët erotike. Këtë e dëshmojnë bindshëm edhe 353 këngët e këtij vëllimi, që janë zgjedhur, seleksionuar e radhitur me kujdesin e duhur nga Rr. Berisha dhe M. Mustafa.

Librit „*Këngë dashurie I*” i paraprin parathënia e shkruar me frymëzim nga Rrustem Berisha. Në këtë parathënie në mënyrë koncize paraqiten veçoritë karakteristike të këngëve të dashurisë, pasuria e tyre tematike-motivore dhe vlerat estetike të kësaj poezie. Autori i parathënies sjell një analizë të plotë lidhur me rrethanat dhe kushtet e krijimit dhe të ruajtjes së kësaj poezie duke pasur parasysh edhe strukturën poetike të krijimeve. Duke u bazuar në poezinë popullore ai i vështron edhe rrethanat sociale dhe etiko-morale të manifestimit të dashurisë, e cila, të paktën në sferën shpirtërore imagjinative e krijuese, i thyen barrierat e shumta të normave e kanuneve karakteristike për rapor-